



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 17 Prot.

Tiranë, 07.01.2022

VENDIM (Qarkullues)

Nr. 01 datë 07.01.2022

**“PËR DETAJIMIN E FONDEVE TË AKORDUARA NË FORMË GRANT
/TRANSFERTË E PAKUSHTËZUAR PËR VITIN 2022”**

Mbështetur në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika ç, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, Vendimin Nr.13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik-Tiranë”, shkresën e MAS Nr.7409/1 Prot, datë 31.12.2021 drejtuar Ministrisë së Financave dhe fondet grant të akorduara për UPT nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në formë elektronike (e-mail) në datën 05.01.2022, si dhe me propozim të Administratorit të Institucionit, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

- 1- Të miratojë detajimin fondeve të akorduara Universitetit Politeknik të Tiranës, në formë grant/transfertë e pakushtëzuar, për vitin 2022, sipas tabelës bashkangjitur;
- 2- Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar

Fatjon DHALLI

Anëtar

Mirela BIMO

Anëtar

Jorgaq KAÇANI

Anëtar

Arjan BEQIRAJ

Anëtar

Alfred PJETRI

Anëtar

Adrian NAÇO

Kryetar

Adriana RISTANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 127/1 Prot.

Tiranë, më 19/01/2022

V E N D I M

Nr. 2, datë 19.01.2022

P Ë R

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË CIKLIT
TË TRETË TË STUDIMIT “DOKTORATË” NË INXHINIERI FIZIKE, PRANË
DEPARTAMENTIT TË INXHINIERISË FIZIKE, NË FAKULTETIN E
INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE, SI DHE
MIRATIMIN E KOSTOS DHE TARIFËS SË STUDIMIT**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM – në nr. 185, datë 25.03.2021, udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e “Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe Vendimin nr. 47, datë 28.12.2021 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 19.01.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për riorganizimin e programit të ciklit të tretë të studimit “Doktoratë” në Inxhinieri Fizike, pranë Departamentit të Inxhinierisë Fizike, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike.

2. Të miratojë koston dhe tarifën e studimit për riorganizimin e programit të sipërcituar, sipas materialit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Jorgaq KAÇANI

Anëtar
Mirela BIMO

Anëtar
Fatjon DHULLI

Anëtar
Arjan BEQIRAJ

Anëtar
Alfred PJETRI

Anëtar
Ardian NAÇO

Kryetar
Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 127/12 Prot.

Tiranë, më 19/01 /2022

V E N D I M

Nr. 3, datë 19.01.2022

P Ë R

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË CIKLIT
TË TRETË TË STUDIMIT “DOKTORATË” NË INXHINIERI MATEMATIKE,
PRANË DEPARTAMENTIT TË INXHINIERISË MATEMATIKE, NË
FAKULTETIN E INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE,
SI DHE MIRATIMIN E KOSTOS DHE TARIFËS SË STUDIMIT**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM – në nr. 185, datë 25.03.2021, udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e “Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe Vendimin nr. 48, datë 28.12.2021 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 19.01.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për riorganizimin e programit të ciklit të tretë të studimit “Doktoratë” në Inxhinieri Matematike, pranë Departamentit të Inxhinierisë Matematike, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike.

2. Të miratojë koston dhe tarifën e studimit për riorganizimin e programit të sipërcituar, sipas materialit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 127/3 Prot.

Tiranë, më 18 / 01 /2022

V E N D I M

Nr. 4, datë 18 . 01 .2022

P Ë R

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË CIKLIT TË TRETË
TË STUDIMIT “DOKTORATË” NË INXHINIERI E BURIMEVE MINERARE,
PRANË DEPARTAMENTIT TË INXHINIERISË SË BURIMEVE MINERARE, NË
FAKULTETIN E GJEOLOGJISË DHE TË MINIERAVE, SI DHE MIRATIMIN E
KOSTOS DHE TARIFËS SË STUDIMIT**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM – në nr. 185, datë 25.03.2021, udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e “Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe Vendimin nr. 46, datë 24.12.2021 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 19.01.2022,

V E N D O S I:

1. Të miratojë propozimin për hapjen e programit të ciklit të tretë të studimit “Doktoratë” në Inxhinieri e Burimeve Minerare, pranë Departamentit të Inxhinierisë së Burimeve Minerare, në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave.
2. Të miratojë koston dhe tarifën e studimit për riorganizimin e programit të sipërcituar, sipas materialit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI



3. Materiale didaktike, bibliografike, revista shkencore etj.	50.000 Lekë
4. Bazë materiale për kërkimet shkencore (reagentë, pajisje profesionale fushore)	200.000 Lekë
5. Pjesmarrja në konferenca dhe botime në revista	200.000 Lekë
Total të daljet	1.101.990 Lekë
HYRJE - DALJE	
TOTAL	0.0 Lekë

1. Didaktike

<i>Leksione</i>	<i>112 ore</i>
<i>Seminare/ushtrime</i>	<i>112.5 ore</i>
<i>Laboratore</i>	<i>26.25 ore</i>
<i>Praktike</i>	<i>0 ore</i>
<i>Projekt/detyra kursi</i>	<i>15 ore</i>

265.75 orë mësimore x 1320 lekë/ora = **350.790 Lekë**

2. Udhëheqje e punimit përfundimtar (DISERTACION)

2 vite x 80 ore x 1320 leke/ora = **211.200 Lekë**

Shuma B: = **561.990 Lekë**

SHUMA A+B = **651.790Lekë**

C. Materiale didaktike, bibliografike, etj. dhe blerje materialesh të inventarizueshme:

Abonime në revista shkencore =50,000 Lekë

Shuma C: = **50.000 Lekë**

D. Shpenzime të tjera(reagente, pajisje profesionale fushore, mirembajtje te pajisjeve)
= 200.000 Lekë

Shuma D = **200.000 Lekë**

E. Pjesëmarrja në Konferenca shkencore dhe botime në revista me IF = 200.000 Lekë

Shuma E = **200.000 Lekë**

GJITHSEJ (A+B+C+D+E) = **1.101.990 Lekë**

Kosto për një person : 1.101.990 Lekë

Kjo kosto për një kandidat do të ndryshojë në krahasim me atë të llogaritur, në përputhje me ndryshimet në indeksimin e pagave, në vlerën e pagueshme të orëve mësimore apo të konvertimit të tyre, me numrin e kandidateve që pranohen si dhe me financime të tjera të ligjshme nga kompanite e interesuara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 127/4 Prot.

Tiranë, më 19/01 /2022

V E N D I M

Nr. 5, datë 19 . 01 .2022

PËR

MIRATIMIN E TARIFAVE TË REGJISTRIMIT DHE TARIFAVE VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR”, PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, SI DHE PROGRAMEVE TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE” ME KOHË TË PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2021-2022 NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, shkronja c, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 2, paragrafi dytë, shkronja d, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe Vendimin e Senatit Akademik nr. 45, datë 24.12.2021, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 19.01.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e regjistrimit për programet e studimit në Universitetin Politeknik të Tiranës për vitin akademik 2021 – 2022, sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë tarifat vjetore të shkollimit për programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” me kohë të plotë, për vitin akademik 2021 – 2022 sipas tabelave nr. 2, 3 dhe 4 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Tarifa e shkollimit paguhet nga studentët në masën, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.
4. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti i cilësuar në bazë të rregullores së institucionit si përsëritës, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.

5. Studenti i regjistruar në një program të ciklit të parë ose në një program të integruar të studimeve, i cili nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në programin përkatës të studimit brenda kohëzgjatjes normale të tij (3 vjet cikli i parë dhe 5 vjet studimet e integruara), do të paguajë vetëm për provimet që do të japë për lëndët e mbartura gjatë vitit akademik 2021 - 2022.
6. Studenti i regjistruar në një program të ciklit të dytë i cili nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në programin përkatës të studimit brenda kohëzgjatjes normale të studimit (Master Profesional dhe Master i Shkencave), do të paguajë vetëm për provimet që do të japë për lëndët e mbartura gjatë vitit akademik 2021 – 2022.
7. Pagesa e tarifës së shkollimit për ciklin e parë të studimeve dhe programin e integruar të studimeve, kryhet përpara fillimit të sezonit të provimeve të dimrit.
8. Pagesa e tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve, kryhet e ndarë në 2 (dy) këste. Kësti i parë të paguhet përpara fillimit të sezonit të provimeve të dimrit dhe kësti i dytë paguhet përpara fillimit të sezonit të provimeve të verës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Jorgaq KAÇANI

Anëtar
Mirela BIMO

Anëtar
Fatjon DHULLI

Anëtar
Arjan BEQIRAJ

Anëtar
Alfred PJETRI

Anëtar
Ardian NAÇO

Kryetar
Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 127/5 Prot.

Tiranë, më 19/01/2022

V E N D I M

Nr. 6, datë 19.01.2022

PËR

MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, TË CILËT NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË OSE NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, QË PLOTËSOJNË KRITERET PËR PËRJASHTIMIN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT DHE PËRFITIMIN E BURSËS, SI DHE LISTËS SË STUDENTËVE TË CILËT NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË DYTË, QË PLOTËSOJNË KRITERET PËR ULJEN E TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT NË MASËN 50%, PËR VITIN AKADEMIK 2021 - 2022

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM – në nr. 269, datë 29.03.2017 të ndryshuar, pika 2.2, VKM - në nr. 903, datë 21.12.2016, të ndryshuar, pika 3.1, VKM - në nr. 780, datë 26.12.2018, pika 3, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës” si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 19.01.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë listat e studentëve, të cilët ndjekin studimet në një program të ciklit të parë ose në një program të integruar të studimeve me kohë të plotë, që plotësojnë kriteret për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit dhe përfitimin e bursës financiare, për vitin akademik 2021 - 2022, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Të miratojë listën e studentëve, të cilët ndjekin studimet në një program të ciklit të dytë me kohë të plotë, që plotësojnë kriteret për uljen e tarifës vjetore të shkollimit në masën 50%, për vitin akademik 2021 - 2022, sipas materialit bashkëlidhur.

3. Pagesa e bursave financiare për studentët që kanë aplikuar përpara datës 01.12.2021, të kryhet nga fillimi i vitit akademik. Për studentët që kanë aplikuar pas kësaj date, pagesa e bursës financiare të kryhet nga muaji pasardhës i aplikimit.
4. Ky vendim t'i njoftohet MASR-së dhe AKFAL-it, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës, për vitin 2022.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 127/6 Prot.

Tiranë, më 19/01/2022

V E N D I M

Nr. 7, datë 19.01.2022

P Ë R

MIRATIMIN E PROJEKT BUXHETIT AFATMESËM 2022 – 2024 TË
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenin 49, pika 1, gërma c, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 2, paragrafi II, shkronja b, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe Vendimin nr. 44, datë 24.12.2021 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 19.01.2022,

V E N D O S I:


1. Të miratojë Projekt Buxhetin Afatmesëm 2022 – 2024 të Universitetit Politeknik të Tiranës, sipas materialit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 396 Prot.

Tiranë, më 24 /02 /2022

V E N D I M

Nr. 08 datë, 24 . 02 .2022

P Ë R

**MIRATIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURËS SË PUNËSIMIT TË
ADMINISTRATORËVE TË NJËSIVE KRYESORE NË UNIVERSITETIN
POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja f dhe neni 53, pika 2, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 354 prot., datë 21.02.2022, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë kriteret dhe procedurën e punësimit të Administratorëve të njësive kryesore në Universitetin Politeknik të Tiranës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI
Adriana RISTANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 356/1 Prot.

Tiranë, më 24 / 02 /2022

V E N D I M

Nr. 09 , datë 24 . 02 .2022

P Ë R

MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, TË CILËT NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË OSE NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, TË CILËT PËRFITOJNË PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT DHE BURSË FINANCIARE, SI DHE LISTËS SË STUDENTËVE TË CILËT NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË DYTË, TË CILËT PËRFITOJNË ULJE TË TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT NË MASËN 50%, PËR VITIN AKADEMIK 2021 - 2022

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM – në nr. 269, datë 29.03.2017 të ndryshuar, pika 2.2, VKM - në nr. 903, datë 21.12.2016, të ndryshuar, pika 3.1, VKM - në nr. 780, datë 26.12.2018, pika 3, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 88/1 prot., datë 11.02.2022 , Bordi i Administrimit

V E N D O S I:

1. Të miratojë listat e studentëve, të cilët ndjekin studimet në një program të ciklit të parë ose në një program të integruar të studimeve me kohë të plotë, të cilët përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit dhe bursë financiare, për vitin akademik 2021 - 2022, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Të miratojë listën e studentëve, të cilët ndjekin studimet në një program të ciklit të dytë me kohë të plotë, të cilët përfitojnë ulje të tarifës vjetore të shkollimit në masën 50%, për vitin akademik 2021 - 2022, sipas materialit bashkëlidhur.
3. Pagesa e bursave financiare për studentët që kanë aplikuar përpara datës 01.12.2021, të kryhet nga fillimi i vitit akademik. Për studentët që kanë aplikuar pas kësaj date, pagesa e bursës financiare të kryhet nga muaji pasardhës i aplikimit.

4. Ky vendim t'i njoftohet MAS-së dhe AKFAL-it, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës, për vitin 2022.
5. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 396/2 Prot.

Tiranë, më 24 / 02 / 2022

V E N D I M

Nr. 10 datë 24 . 02 . 2022

P Ë R

**MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE TË CILËT KANË PËRFUNDUAR VITIN
PARAARDHËS AKADEMIK ME NOTË MESATARE TË PAKTËN GJASHTË (6) DHE QË
PËRFITOJNË REDUKTIM TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT NË MASËN 50%, PËR VITIN
AKADEMIK 2021 – 2022**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM - në nr. 778, datë 26.12.2018, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 168/3 prot, datë 11.02.2022, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën e studentëve, të cilët kanë përfunduar vitin paraardhës akademik me notë mesatare të paktën gjashtë (6) dhe që përfitojnë reduktim të tarifës vjetore të në masën 50%, për vitin akademik 2021 - 2022, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ky vendim t’i njoftohet MAS-së dhe AKFAL-it, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës për vitin 2022.
3. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Jorgaq KAÇANI

Anëtar
Mirela BIMO

Anëtar
Fatjon DHULLI

Anëtar
Arjan BEQIRAJ

Anëtar
Alfred PJETRI

Anëtar
Ardian NAÇO

Kryetar
Adriana RISTANI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 396 / Prot.
3

Tiranë, më 24 / 02 / 2022

V E N D I M

Nr. 11 datë 24 . 02 . 2022

P Ë R

**DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 23, DATË 27.10.2020 TË BORDIT
TË ADMINISTRIMIT**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM-në nr. 112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standarteve për fitimin e titujve akademik “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, VKM-në nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, pika 18, Udhëzimin nr. 29, datë 10.09.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 127/9 prot., datë 11.02.2022, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

Në vendimin nr. 23, datë 27.10.2020 të Bordit të Administrimit, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Të miratojë masën e pagesës për anëtarët e personelit akademik, të cilët caktohen anëtarë në juritë për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, si dhe në juritë për fitimin e titujve akademik “Profesor” dhe “Profesor i asociuar”, në Universitetin Politeknik të Tiranës.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Masa e pagesës për anëtarët e jurive për mbrojtjen e gradës shkencore “Doktor”, përllogaritet për orë mësimi si më poshtë:

- Kryetar 15 orë;
- Anëtarë 10 orë;

Masa e pagesës për anëtarët e jurive për fitimin e titujve akademik “Profesor” dhe “Profesor i asociuar”, përlllogaritet për orë mësimi si më poshtë:

- Kryetar 20 orë;
- Anëtarë 15 orë;

3. Ngarkohet Administratori i Institucionit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETARI

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 476/19 Prot.

Tiranë, më 16/03/2022

V E N D I M (QARKULLUES)

Nr. 12, datë 16.03.2022

PËR

**MIRATIMIN E KUOTAVE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE NË PROGRAMET E
CIKLIT TË PARË BACHELOR, PROGRAMIN E INTEGRUAR TË STUDIMEVE, SI
DHE NË PROGRAMET E CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE” DHE
“MASTER PROFESIONAL” NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR
VITIN AKADEMIK 2022 - 2023**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 69, pika 3, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës neni 52, pika 4 dhe neni 9, pika 3, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe vendimin nr. 4, datë 11.03.2022 të Senatit Akademik, si dhe shkresën nr. 476/8 prot., datë 15.03.2022 të Rektorit të UPT-së, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë kuotat e pranimit të studentëve në programet e ciklit të parë Bachelor, në programin e integruar të ciklit të dytë, si dhe në programet e ciklit të dytë “Master i Shkencave” dhe “Master Profesional” në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2022 – 2023, sipas materialit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 673/16 Prot.

Tiranë, më 06/04 /2022

V E N D I M

Nr. 13, datë 06.04.2022

P Ë R

MIRATIMIN E RAPORTIT PËR REALIZIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2021 DHE
DETAJIMIN E BUXHETIT TE VITIT 2022”

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja c, Statutin e UPT - së, neni 10, pika 2, shkronja b, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe vendimin nr. 5, datë 30.03.2022 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 06.04.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë raportin financiar për realizimin e buxhetit të vitit 2021;
2. Të miratojë raportin e detajuar të buxhetit të konsoliduar për vitin 2022, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 769/2 Prot.

Tiranë, më 06/04 /2022

V E N D I M

Nr. 14, datë 06.04.2022

P Ë R

MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, TË CILËT NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË OSE NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, TË CILËT PËRFITOJNË PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT DHE BURSË FINANCIARE, SI DHE LISTËS SË STUDENTËVE TË CILËT NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË DYTË, TË CILËT PËRFITOJNË ULJE TË TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT NË MASËN 50%, PËR VITIN AKADEMIK 2021 - 2022

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM – në nr. 269, datë 29.03.2017 të ndryshuar, pika 2.2, VKM - në nr. 903, datë 21.12.2016, të ndryshuar, pika 3.1, VKM - në nr. 780, datë 26.12.2018, pika 3, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 769 prot., datë 06.04.2022, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listat e studentëve, të cilët ndjekin studimet në një program të ciklit të parë ose në një program të integruar të studimeve me kohë të plotë, të cilët përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit dhe bursë financiare, për vitin akademik 2021 - 2022, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Të miratojë listën e studentëve, të cilët ndjekin studimet në një program të ciklit të dytë me kohë të plotë, të cilët përfitojnë ulje të tarifës vjetore të shkollimit në masën 50%, për vitin akademik 2021 - 2022, sipas materialit bashkëlidhur.
3. Pagesa e bursave financiare të kryhet nga muaji pasardhës kur studenti ka paraqitur kërkesën.

4. Ky vendim t'i njoftohet MAS-së dhe AKFAL-it, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës, për vitin 2022.
5. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Jorgaq KAÇANI

Anëtar
Mirela BIMO

Anëtar
Fatjon DHULI

Anëtar
Arjan BEQIRAJ

Anëtar
Alfred PJETRI

Anëtar
Adrian NAÇO

Kryetar
Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 769/3 Prot.

Tiranë, më 06/04 /2022

V E N D I M

Nr. 15, datë 06.04.2022

P Ë R

MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, TË CILËT NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË OSE NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, TË CILËT PËRFITOJNË PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT DHE BURSË FINANCIARE, SI DHE LISTËS SË STUDENTËVE TË CILËT NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË DYTË, TË CILËT PËRFITOJNË ULJE TË TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT NË MASËN 50%, PËR VITIN AKADEMIK 2021 – 2022, ME KRITERE TË VEÇANTA

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM – në nr. 269, datë 29.03.2017 të ndryshuar, pika 2.2, VKM - në nr. 903, datë 21.12.2016, të ndryshuar, pika 3.1, VKM - në nr. 780, datë 26.12.2018, pika 3, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 769/1 prot., datë 06.04.2022, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë listat e studentëve, të cilët ndjekin studimet në një program të ciklit të parë ose në një program të integruar të studimeve me kohë të plotë, të cilët përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit dhe bursë financiare për vitin akademik 2021 - 2022, me kritere të veçanta, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Të miratojë listën e studentëve, të cilët ndjekin studimet në një program të ciklit të dytë me kohë të plotë, të cilët përfitojnë ulje të tarifës vjetore të shkollimit në masën 50% për vitin akademik 2021 - 2022, me kritere të veçanta, sipas materialit bashkëlidhur.
3. Pagesa e bursave financiare të kryhet nga muaji pasardhës kur studenti ka paraqitur kërkesën.

4. Ky vendim t'i njoftohet MAS-së dhe AKFAL-it, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universitetit Politeknik të Tiranës, për vitin 2022.
5. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 770/1 Prot.

Tiranë, më 06/04/2022

V E N D I M

Nr. 16 datë 06.04.2022

P Ë R

MIRATIMIN E KANDIDATIT TË PËRZGJEDHUR FITUES PËR ADMINISTRATOR
NË FAKULTETIN E GJEOLGJISË DHE TË MINIERAVE

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1/f, neni 52, pika 1/e, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, vendimin nr. 8, datë 24.02.2022 të Bordit të Administrimit “Për caktimin e kritereve dhe procedurës së punësimit të administratorëve të njësive kryesore në Universitetin Politeknik të Tiranës”, vendimin nr. 80, datë 05.04.2022 të Administratorit të Institucionit “Për përzgjedhjen e kandidatit fitues për administrator në FGJM”, si dhe relacionin nr. 770 prot., datë 06.04.2022 të Administratorit të Institucionit, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Të miratojë kandidatin e përzgjedhur fitues për administrator në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, Z. Selam Aga.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Kryetar

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1004 Prot.

Tiranë, më 28/04 /2022

V E N D I M (QARKULLUES)

Nr. 17, datë 28.04.2022

“PËR

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT NË
CIKLIN E TRETË ME DIPLOMË TË DYFISHTË, STUDIME TË DOKTORATËS
NË “QËNDRUESHMËRIA DHE INOVACIONI PËR PROJEKTIN E MJEDISIT TË
NDËRTUAR DHE SISTEMIT TË PRODUKTIT” MIDIS DEPARTAMENTIT TË
ARKITEKTURËS (DIDA) TË UNIVERSITA DEGLI STUDI DI FIRENZE (UNIFI),
DHE DEPARTAMENTIT TË ARKITEKTURËS, DEPARTAMENTIT TË
URBANISTIKËS DHE DEPARTAMENTIT TË TEKNOLOGJISË SË
ARKITEKTURËS DHE RESTAURIMIT NË FAKULTETIN E ARKITEKTURËS
DHE URBANISTIKËS, TË UPT”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM – në nr. 185, datë 25.03.2021, udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e “Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe Vendimin nr. 8, datë 28.04.2022 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për hapjen e programit të studimit në ciklin e tretë me diplomë të dyfishtë, studime të Doktoratës në “Qëndrueshmëria dhe inovacioni për projektin e mjedisit të ndërtuar dhe sistemit të produktit” midis Departamentit të Arkitekturës (DIDA) të Universita degli Studi di Firenze (UNIFI), dhe Departamentit të Arkitekturës, Departamentit të Urbanistikës dhe Departamentit të Teknologjisë së Arkitekturës dhe

Restaurimit në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, të Universitetit Politeknik të Tiranës.

2. Të miratojë koston dhe tarifën e studimit për hapjen e programit të sipërcituar, sipas materialit bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1424/1 Prot.

Tiranë, më 15/06/2022

V E N D I M

Nr. 18, datë 15.06.2022

P Ë R

**MIRATIMIN E PAGESËS SË ORËVE TË PUNËS TË KRYERA JASHTË KOHËS
NORMALE TË PUNËS DHE NË DITËT E PUSHIMIT JAVOR, NGA PUNONJËSIT E
SEKRETARIVE MËSIMORE**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja ë, Udhëzimin nr. 10 datë 15.05.2019 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar, Urdhrin e Përbashkët të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe Qendrës Ndërinstitucionale të Rrjetit Akademik Shqiptar nr. 6, datë 25.06.2021 “Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2021-2022”, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Urdhrin nr. 39 datë 01.09.2021 të Rektorit të UPT – së “Për ndryshimin e orarit të punës të Sekretarive Mësimore gjatë periudhës së regjistrimit të studentëve”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 1424 prot., datë 09.06.2022, Bordi i Administrimit i UPT-së,

VENDOSI:

1. Të miratojë pagesën e orëve të punës të kryera jashtë kohës normale të punës dhe në ditët e pushimit javor nga punonjësit e sekretarive mësimore në periudhën shtator - tetor 2021, për procedurat e pranimit dhe regjistrimit të studentëve fitues në vitin akademik 2021 – 2022 në Universitetin Politeknik të Tiranës, sipas relacionit të administratorit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Administratori i Institucionit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Jorgaq KACANI



Anëtar
Mirela BIMO

Anëtar
Alfred PJETRI



Anëtar
Fatjon DHULI

Kryetar
Adriana RISTANI



Anëtar
Arjan BEQIRAJ



Anëtar
Adrian NAÇO





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1425/11 Prot.

Tiranë, më 15/06/2022

V E N D I M

Nr. 19, datë 15.06.2022

P Ë R

MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE, TË CILËT NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË PARË OSE NË NJË PROGRAM TË INTEGRUAR TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, QË PLOTËSOJNË KRITERET PËR PËRJASHTIMIN NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT, SI DHE LISTËS SË STUDENTËVE TË CILËT NDJEKIN STUDIMET NË NJË PROGRAM TË CIKLIT TË DYTË, QË PLOTËSOJNË KRITERET PËR ULJEN E TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT NË MASËN 50%, PËR VITIN AKADEMIK 2021 – 2022

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM – në nr. 269, datë 29.03.2017 të ndryshuar, pika 2.2, VKM - në nr. 903, datë 21.12.2016, të ndryshuar, pika 3.1, VKM - në nr. 780, datë 26.12.2018, pika 3, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 1425 prot., datë 09.06.2022 dhe nr. 1462 prot., datë 15.06.2022, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë listat e studentëve, të cilët ndjekin studimet në një program të ciklit të parë ose në një program të integruar të studimeve me kohë të plotë, që plotësojnë kriteret për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2021 - 2022, sipas relacionit të administratorit bashkëlidhur.
2. Të miratojë listën e studentëve, të cilët ndjekin studimet në një program të ciklit të dytë me kohë të plotë, që plotësojnë kriteret për uljen e tarifës vjetore të shkollimit në masën 50%, për vitin akademik 2021 - 2022, sipas relacionit të administratorit bashkëlidhur.

3. Ky vendim t'i njoftohet MASR-së dhe AKFAL-it, shoqëruar me kërkesën për rimbursimin e fondeve të efektit financiar që sjellin këto kategori në buxhetin e Universtitetit Politeknik të Tiranës, për vitin 2022.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Jorgaq KAÇANI

Anëtar
Mirela BIMO

Anëtar
Fatjon DHULI

Anëtar
Arjan BEQIRAJ

Anëtar
Alfred PJETRI

Anëtar
Adrian NAÇO

Kryetar
Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 673/7 Prot.

Tiranë, më 15/06/2022

V E N D I M

Nr. 20, datë 15.06.2022

P Ë R

**MIRATIMIN E TARIFAVE PËR NDJEKJEN E PROCEDURËS SË FITIMIT TË
TITUJVE AKADEMIK "PROFESOR" DHE "PROFESOR I ASOCIUAR" NË
UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 49 dhe 61, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Vendimin nr. 112, datë 23.02.2018 "Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore "Doktor" dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademik "Profesor i asociuar" dhe "Profesor", Udhëzimin e MASR nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë", Statutin e UPT - së, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 të Bordit të Administrimit "Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës", si dhe vendimin nr. 07, datë 30.03.2022 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifën në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, për ndjekjen e procedurës së fitimit të titujve akademik "Profesor" dhe "Profesor i asociuar" në Universitetin Politeknik të Tiranës.
2. Për aplikantët të cilët janë personel akademik me kohë të plotë në Universitetin Politeknik të Tiranës, tarifa përballohet nga të ardhurat e institucionit.

3. Për aplikantët të cilët vijnë nga jashtë Universitetit Politeknik të Tiranës, tarifa përballohet nga vetë aplikanti ose nga institucioni nga i cili vjen, sipas marrëveshjes për të cilën palët kanë rënë dakord paraprakisht.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet për të gjitha aplikimet që kryhen pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Jorgaq KAÇANI



Anëtar
Mirela BIMO

Anëtar
Alfred PJETRI



Anëtar
Fatjon DHULI

Kryetar
Adriana RISTANI



Anëtar
Arjan BEQIRAJ



Anëtar
Adrian NAÇO





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1590/1 Prot.

Tiranë, më 25/07 /2022

V E N D I M (QARKULLUES)

Nr. 21, datë 25.07.2022

MIRATIMIN E TARIFËS SË REGJISTRIMIT NË KONKURSIONIN E PRANIMIT NË
FAKULTETIN E ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS, PËR VITIN
AKADEMIK 2022 - 2023

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 1, shkronja ç, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 2, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe Vendimin nr. 15, datë 21.07.2022 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifën e regjistrimit në konkursin/testimin e pranimit në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës për vitin akademik 2022 – 2023, në vlerën 3000 (tre mijë) lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1823 Prot.

Tiranë, më 27 / 07 / 2022

V E N D I M

Nr. 22, datë 27 . 07 . 2022

P Ë R

MIRATIMIN E TARIFAVE TË REGJISTRIMIT DHE TARIFAVE VJETORE TË SHKOLLIMIT PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË “BACHELOR”, PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË, SI DHE PROGRAMEVE TË CIKLIT TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” DHE “MASTER I SHKENCAVE” ME KOHË TË PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023 NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 3, shkronja c, vendimin nr. 288, datë 21.05.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë”, i ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 26, pika 3, si dhe vendimin nr. 14, datë 21.07.2022 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e regjistrimit për programet e studimit në Universitetin Politeknik të Tiranës për vitin akademik 2022 – 2023, sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Të miratojë tarifat vjetore të shkollimit për programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, si dhe programet e studimit të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” me kohë të plotë, për vitin akademik 2022 – 2023 sipas tabelave nr. 2, 3 dhe 4 bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Tarifa e shkollimit paguhet nga studentët në masën, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.

4. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi. Studenti i cilësuar në bazë të rregullores së institucionit si përsëritës, i nënshtrohet tarifës vjetore të shkollimit të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.
5. Studenti i regjistruar në një program të ciklit të parë ose në një program të integruar të studimeve, i cili nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në programin përkatës të studimit brenda kohëzgjatjes normale të tij (3 vjet cikli i parë dhe 5 vjet studimet e integruara), do të paguajë vetëm për provimet që do të japë për lëndët e mbartura gjatë vitit akademik 2022 - 2023.
6. Studenti i regjistruar në një program të ciklit të dytë “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave”, i cili nuk i ka shlyer të gjitha detyrimet e parashikuara në programin përkatës të studimit brenda kohëzgjatjes normale të studimit, do të paguajë vetëm për provimet që do të japë për lëndët e mbartura gjatë vitit akademik 2022 – 2023.
7. Pagesa e tarifës së shkollimit për ciklin e parë të studimeve dhe programin e integruar të studimeve, kryhet përpara fillimit të sezonit të provimeve të dimrit.
8. Pagesa e tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve, kryhet e ndarë në 2 (dy) këste. Kësti i parë të paguhet përpara fillimit të sezonit të provimeve të dimrit dhe kësti i dytë paguhet përpara fillimit të sezonit të provimeve të verës.
9. Në situata objektive që e bëjnë të pamundur respektimin e afateve të përcaktuara për pagesën e tarifës së shkollimit, njësitet kryesore të kenë mundësi veprimi për metodologjinë dhe afatet e pagesave.
10. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe fakultetet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 980/2 Prot.

Tiranë, më 27/07/2022

V E N D I M

Nr. 23, datë 27.07.2022

P Ë R

**MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË STUDIMIT NË CIKLIN
E DYTË “MASTER I SHKENCAVE” NË INXHINIERI MEKANIKE, PROFILI
ENERGJITIKË ME UNIVERSITETIN E TUSCIA-S NË VITERBO, ITALI, NË
FAKULTETIN E INXHINIERISË MEKANIKE**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, Kreu IV, shkronja A, pika 3/b, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, vendimin nr. 11, datë 28.04.2022 të Senatit Akademik, si dhe shkresën nr. 980/2 prot., datë 15.06.2022 të Rektorit të UPT-së, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të përbashkët të studimit në ciklin e dytë “Master i Shkencave” në Inxhinieri Mekanike, profili Energjitikë me Universitetin e Tuscia-s në Viterbo, Itali, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, Universiteti Politeknik i Tiranës.
2. Të miratojë tarifën e shkollimit për këtë program studimi në vlerën 168.000 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë.
3. Ngarkohen Administratori i Institucionit dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1823/1 Prot.

Tiranë, më 27/07 /2022

V E N D I M

Nr. 24, datë 27.07.2022

P Ë R

**MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË
“GJEOLGJI” NË FUSHAT: MINERALOGJI, PETROLOGJI-PETROGRAFI,
PALEONTOLOGJI (MIKRO DHE MAKRO) DHE GJEOKIMI NË FAKULTETIN E
GJEOLGJISË DHE TË MINIERAVE, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË
TIRANËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, Kreu IV, shkronja A, pika 3/b, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, vendimin nr. 17, datë 21.07.2022 të Senatit Akademik, si dhe shkresën nr. 1765/9 prot., datë 21.02.2022 të Rektorit të UPT-së, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të formimit të vazhduar në “Gjeologji” në fushat: Mineralogji, Petrologji-Petrografi, Paleontologji (Mikro dhe Makro) dhe Gjeokimi në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, në Universitetin Politeknik të Tiranës.
2. Të miratojë tarifën e studimit për këtë program në vlerën 500.000 (pesëqind mijë) lekë.
3. Ngarkohen Administratori i Institucionit dhe Fakulteti i Gjeologjisë dhe i Minierave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1694/13 Prot.

Tiranë, më 27/07 /2022

V E N D I M

Nr. 25, datë 27.07.2022

P Ë R

**MIRATIMIN E PËRJASHTIMIT NGA TARIFA E SHKOLLIMIT PËR PERSONELIN
AKADEMIK, NDIHMËSAKADEMIK DHE ADMINISTRATIV TË UNIVERSITETIT
POLITEKNIK TË TIRANËS, TË CILËT NDJEKIN NJË PROGRAM TË FORMIMIT
TË VAZHDUAR TË OFRUAR NGA UPT**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 67, pika 2, Vendimin nr. 329, datë 12.04.2017 të Këshillit të Ministrave “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, pika 14, shkronja b dhe pika 15, shkronja c, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës neni 35, pika 1, shkronjat a dhe b, si dhe pika 2, shkronja c, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 1694/2 prot., datë 26.07.2022, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë përjashtimin nga pagesa e tarifës së shkollimit për personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ të Universitetit Politeknik të Tiranës, të cilët ndjekin programet e formimit të vazhduar të ofruara nga UPT, me qëllim trajnimin dhe kualifikimin e tyre.
2. Personeli i cili ka në fuqi masë disiplinore, përjashtohet nga e drejta për të ndjekur programet e formimit të vazhduar pa pagesë sipas përcaktimit në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1731/2 Prot.

Tiranë, më 27.07/2022

V E N D I M

Nr. 26, datë 27.07.2022

P Ë R

MIRATIMIN E KËRKESËS SË STUDENTES ATEA ALINANI PËR REDUKTIMIN
NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM - në nr. 780, datë 26.12.2018, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 1731/1 prot., datë 26.07.2022, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e studentes Atea Alinani, studente në programin e ciklit të dytë “Master i Shkencave” pranë Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, për reduktimin e tarifës vjetore të shkollimit në masën 50%, sipas relacionit të administratorit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

K R Y E T A R

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1823/2 Prot.

Tiranë, më 27/07 /2022

V E N D I M

Nr. 27, datë 27.07.2022

PËR

**MIRATIMIN E PROJEKT BUXHETIT AFATMESËM 2023-2025 TË UNIVERSITETIT
POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja c, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 2, paragrafi II, shkronja b, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe Vendimin nr. 16, datë 21.07.2022 të Senatit Akademik, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë Projekt Buxhetin Afatmesëm 2023-2025 të Universitetit Politeknik të Tiranës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1545/2 Prot.

Tiranë, më 27/07/2022

V E N D I M

Nr. 28, datë 27.07.2022

P Ë R

FILLIMIN E PROCEDURËS SË PUNËSIMIT PËR POZICIONIN “PËRGJEGJËS NË SEKTORIN E AUDITIT TË BRENDSHËM” NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, SI DHE MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE TË KRITEREVE DHE PROCEDURËS SË PUNËSIMIT PËR KËTË POZICION

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja f, udhëzimin nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, pika 17, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe informacionit të dërguar nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike me shkresën nr. 1545/1 prot., datë 30.06.2022, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Fillimin e procedurës së punësimit për pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Auditit të Brendshëm në Universitetin Politeknik të Tiranës.
2. Ndryshimin e kriterëve dhe procedurës së punësimit, të miratuara me vendimin nr. 20, datë 27.04.2021 të Bordit të Administrimit për pozicionin e Përgjegjës të Sektorin e Auditit të Brendshëm, sipas dokumentit bashkëlidhur.
4. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2254/Prot.

Tiranë, më 12 / 10 /2022

V E N D I M (QARKULLUES)

Nr. 29 , datë 12 . 10 .2022

PËR

**DETAJIMIN E RISHPËRNDARJES SË FONDEVE BUXHETORE TË AKORDUARA
PËR VITIN 2022**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, shkronja c, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, shkresën nr. 5164/2 prot., datë 02.08.2022 të MAS “Dërgohet për miratim rishpërndarja e fondeve për vitin 2022 – 2023”, si dhe relacionin nr. 2254 prot., datë 11.10.2022 të Administratorit të Institucionit, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për detajimin e rishpërndarjes së fondeve buxhetore të akorduara për vitin 2022 sipas tabelës bashkëlidhur në zërat:
 - 600 (shpenzime për pagesën e orëve mësimore të pedagogëve);
 - 602 (shpenzime për udhëtime e botime);
 - 606 (shpenzime për bursa të studentëve dhe pedagogëve).
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 2444/2 Prot.

Tiranë, më 01/11 /2022

V E N D I M (QARKULLUES)

Nr. 30, datë 01.11.2022

PËR
MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PERSONELIT AKADEMIK NË
UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 47, VKM-në nr. 748 datë 11.06.2009 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, të ndryshuar me vendimin nr. 268, datë 29.03.2017 dhe vendimin nr. 647 datë 05.10.2022, Kreu II, pika 2, VKM-në nr. 621, datë 28.09.2022, VKM-në nr. 627, datë 28.09.2022, VKM-në nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik” pika 17, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, Vendimin nr. 18, datë 01.11.2022 të Senatit Akademik, shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1979/1 prot., datë 31.10.2022, si dhe relacionin Administratorit të Institucionit nr. 2444 prot., datë 01.11.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë nivelin e pagave të personelit akademik në Universitetin Politeknik të Tiranës, sipas kufirit maksimal të përcaktuar për funksion/titull sipas kolonës në lidhjen 1 të vendimit nr. 647 datë 05.10.2022 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 748 datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”.
2. Efektet financiare për nivelin e pagës të miratuar deri në kufirin maksimal të parashikuar do të përballohen nga të ardhurat dytësore të realizuara nga institucioni.
3. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare prej datës 1 tetor 2022.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 2444 / Prot. 13

Tiranë, më 01 / 11 / 2022

V E N D I M (QARKULLUES)

Nr. 31, datë 01 . 11 . 2022

PËR

DETAJIMIN E FONDEVE BUXHETORE SHITESË TË AKORDUARA PËR VITIN
2022

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 47; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”; udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; VKM-në nr. 621, datë 28.09.2022; VKM-në nr. 627, datë 28.09.2022; VKM-në nr. 647 datë 05.10.2022; vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 1979/1 prot., datë 31.10.2022, si dhe relacionin Administratorit të Institucionit nr. 2444/1 prot., datë 01.11.2022,

VENDOSI:

1. Detajimin e fondeve buxhetore shitesë të akorduara për vitin 2022 në shumën 10.000.000 (dhjetë milion) lekë, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2379/5 Prot.

Tiranë, më 09/11 /2022

V E N D I M

Nr. 33, datë 09.11.2022

P Ë R

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 24, DATË 27.07.2022 TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT “PËR MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË “GJEOLGJI” NË FUSHAT: MINERALOGJI, PETROLOGJI-PETROGRAFI, PALEONTOLOGJI (MIKRO DHE MAKRO) DHE GJEOKIMI NË FAKULTETIN E GJEOLGJISË DHE TË MINIERAVE, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS”

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, Kreu IV, shkronja A, pika 3/b; Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, si dhe shkresën nr. 2379/2 prot., datë 31.10.2022 të Rektorit të UPT-së “Përcillen shkresat mbi tarifën e re të propozuar për Programin e Formimit të Vazhduar në Gjeologji”, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr. 24, datë 27.07.2022 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e hapjes së programit të formimit të vazhduar në “Gjeologji” në fushat: Mineralogji, Petrologji-Petrografi, Paleontologji (Mikro dhe Makro) dhe Gjeokimi në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, në Universitetin Politeknik të Tiranës”, ndryshohet si më poshtë:
2. “Të miratojë tarifën e studimit për këtë program në vlerën 320.000 (treqind e njëzet mijë) lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2571 Prot.

Tiranë, më 09 / 11 /2022

V E N D I M

Nr. 34 , datë 09 . 11 .2022

P Ë R

MIRATIMIN E KËRKESËS SË STUDENTES SIBELA HYSENI PËR PËRJASHTIMIN
NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, neni 105; vendimin nr. 269, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, të ndryshuar, pika 2.2; Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës; Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, si dhe relacionin e Administratorit të Institucionit nr. 2417/2 prot., datë 07.11.2022, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e studentes Sibela Hyseni, studente në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2021 – 2022, sipas relacionit të administratorit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Administratori i Institucionit dhe Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

K R Y E T A R

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2747 Prot.

Tiranë, më 30/11 /2022

V E N D I M (QARKULLUES)

Nr. 35, datë 30.11.2022

PËR

**MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË TË STUDIMEVE
“MASTER I SHKENCAVE” NË “INXHINIERI MATEMATIKE NË
AKTUARISTIKË” NË DEPARTAMENTIN E INXHINIERISË MATEMATIKE, NË
FAKULTETIN E INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE
PRANË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK
2023-2024**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, të ndryshuar, Kreu IV, gërma B, Pika 3/a, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, vendimin nr. 21, datë 21.11.2022 të Senatit Akademik, si dhe shkresën nr. 2662/8 prot., datë 24.11.2022 të Rektorit të UPT-së, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Inxhinieri Matematike në Aktuaristikë” në Departamentin e Inxhinierisë Matematike pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2023-2024.

2. Tarifa totale e shkollimit për këtë program studimi është 168.000 (njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2748 Prot.

Tiranë, më 30/11 /2022

V E N D I M (QARKULLUES)

Nr. 36 , datë 30 . 11 .2022

PËR

MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË CIKLIT TË PARË TË STUDIMEVE
“BACHELOR” NË “INXHINIERI KIMIKE” NË DEPARTAMENTIN E KIMISË,
PRANË FAKULTETIT TË INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË
FIZIKE, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR VITIN
AKADEMIK 2023-2024

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, të ndryshuar, Kreu IV, gërma B, Pika 3/a, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, vendimin nr. 20, datë 21.11.2022 të Senatit Akademik, si dhe shkresën nr. 2662/9 prot., datë 24.11.2022 të Rektorit të UPT-së, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të ciklit të parë të studimeve “Bachelor” në “Inxhinieri Kimike” në Departamentin e Kimisë pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2023-2024.
2. Tarifa e shkollimit për këtë program studimi është 25.000 (njëzetë e pesë mijë) lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. 2749 Prot.

Tiranë, më 30 / 11 / 2022

V E N D I M (QARKULLUES)

Nr. 37, datë 30 . 11 . 2022

PËR

**MIRATIMIN E HAPJES SË PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË CIKLIT TË DYTË
TË STUDIMEVE “MASTER I SHKENCAVE” NË “INTELIGJENCË
ARTIFICIALE DHE OPTIMIZIM” DIPLOMË E DYFISHTË, MIDIS
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS DHE UNIVERSITETIT
TEKNOLOGJIK TË COMPIEGNE (UTC) FRANCË, PËR VITIN AKADEMIK
2023-2024**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, të ndryshuar, Kreu IV, gërma B, Pika 3/a, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, vendimin nr. 22, datë 21.11.2022 të Senatit Akademik, si dhe shkresën nr. 2662/7 prot., datë 24.11.2022 të Rektorit të UPT-së, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të përbashkët të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në “Inteligjencë Artificiale dhe Optimizim” diplomë e dyfishtë, midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Universitetit Teknologjik të Compiegne (UTC) Francë, për vitin akademik 2023-2024.
2. Tarifa totale e shkollimit për këtë program studimi është 200.000 (dyqind mijë) lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2750 Prot.

Tiranë, më 30 / 11 / 2022

V E N D I M (QARKULLUES)

Nr. 38, datë 30 . 11 . 2022

PËR

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË CIKLIT
TË DYTË “MASTER PROFESIONAL” NË “INXHINIERI SOFTWARE” NË
DEPARTAMENTIN E INXHINIERISË INFORMATIKE, NË FAKULTETIN E
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË
TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, të ndryshuar, Kreu IV, gërma B, Pika 3/a, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, vendimin nr. 23, datë 21.11.2022 të Senatit Akademik, si dhe shkresën nr. 2662/10 prot., datë 24.11.2022 të Rektorit të UPT-së, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për riorganizimin e programit të ciklit të dytë “Master Profesional” në “Inxhinieri Software” në Departamentin e Inxhinierisë Informatike, në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit, në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2023-2024.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2131 / Prot.

Tiranë, më 15 / 12 / 2022

V E N D I M

Nr. 39 , datë 15 . 12 . 2022

P Ë R

**MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK DHE VJETOR TË AUDITIT TË BRENDSHËM NË
UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR PERIUDHËN 2023 - 2025**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, udhëzimin nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet e arsimit të lartë”, pika 17, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, neni 10, pika 2, shkronja l, Vendimin nr. 13, datë 17/11/2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, si dhe shkresën nr. 2131/1 prot, datë 5.10.2022 të Sektorit të Auditit të Brendshëm, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin Strategjik dhe Vjetor të Auditit të Brendshëm në Universitetin Politeknik të Tiranës, për periudhën 2023 - 2025, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Sektori i Auditimit të Brendshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1011 / Prot.

Tiranë, më 15 / 12 /2022

V E N D I M

Nr. 40 , datë 15 . 12 .2022

P Ë R

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË
STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË INXHINIERI MEKANIKE
DHE MIRATIMIN E PROJEKTEVE KËRKIMORE-SHKENCORE NË “STUDIMI I
VETIVE ELEKTRIKE TË FIBRAVE TEKSTILE DHE NDIKIMI I TYRE NË
PROCESET E PËRPUNIMIT” DHE “STUDIM MBI VLERËSIMIN NUMERIK TË
EMETIMEVE NDOTËSE NGA MOTORËT ME DJEGJE TË BRENDSHME. RAST NË
STUDIM: SITUATA NË SHQIPËRI, VLERËSIME DHE REKOMANDIME PËR
ARRITJEN E TARGETEVE TË VITIT 2030 NË PËRPUTHJE ME: PLANI
KOMBËTAR PËR ENERGJINË DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE 2021-2030” NË
FAKULTETIN E INXHINIERISË MEKANIKE, NË UPT**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, Kreu IV, shkronja A, pika 3/b, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”, vendimin nr. 9, datë 28.04.2022 të Senatit Akademik, si dhe shkresën nr. 1011 prot., datë 29.04.2022 të Rektorit të UPT-së, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në Inxhinieri Mekanike dhe miratimin e projekteve kërkimore-shkencore në “Studimi i vetive elektrike të fibrave tekstile dhe ndikimi i tyre në proceset përpunimit” dhe “Studim mbi vlerësimin numerik të emetimeve ndotëse nga motorët me djegje të brendshme. Rast në Studim: situata në Shqipëri, vlerësime dhe rekomandime për arritjen e targeteve të vitit 2030 në përputhje me: Planin Kombëtar për energjinë dhe ndryshimet klimatike 2021-2030” në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, në UPT.

2. Të miratojë tarifën e shkollimit për këtë program studimi në vlerën 450.000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

3. Ngarkohen Administratori i Institucionit dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2731/4 Prot.

Tiranë, më 29/12/2022

V E N D I M (QARKULLUES)

Nr. 41, datë 29.12.2022

PËR

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË
STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË INXHINIERI
MATEMATIKE PRANË FAKULTETIT TË INXHINIERISË MATEMATIKE DHE
INXHINIERISË FIZIKE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM – në nr. 185, datë 25.03.2021, udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e “Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 25, datë 22.12.2022 të Senatit Akademik, si dhe shkresën 2731/2 prot., datë 22.12.2022, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në Inxhinieri Matematike, si dhe të miratojë katër projekte kërkimore-shkencore në: “Ndërtimi i modelit matematik për vlerësimin e përputhshmërisë në tekstet shqip”; “Ndërtimi i modeleve matematike diferenciale për përhapjen e sëmundjeve epidemike-fokus pandemia Covid – 19. Projektimi dhe vlerësimi në kohë reale i efektivitetit të masave të kontrollit”; “Studim krahasimor i metodave të ndryshme të analizës hapësinore të të dhënave të reshjeve për modelimin hidrologjik në shkallë pellgu ujëmbledhës. Rast studimor për rajone të caktuara të Shqipërisë (Pellgu ujëmbledhës i Prespës)”; “Metoda të avancuara numerike për simulimin e materialeve

sintetike”, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, në Universitetin Politeknik të Tiranës.

2. Tarifa e shkollimit për këtë program studimi është 450 000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Jorgaq KAÇANI

Anëtar
Mirela BIMO

Anëtar
Fatjon DHULLI

Anëtar
Arjan BEQIRAJ

Anëtar
Alfred PJETRI

Anëtar
Adrian NAÇO

Kryetar
Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2951/4 / Prot.

Tiranë, më 29/12 /2022

V E N D I M (QARKULLUES)

Nr. 42, datë 29.12.2022

PËR

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË
STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË INXHINIERI
MEKANIKE, ME NËNFUSHË INXHINIERI MEKANIKE DHE NËNFUSHË
INXHINIERI E MATERIALEVE, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË
MEKANIKE NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM – në nr. 185, datë 25.03.2021, udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e “Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 27, datë 22.12.2022 të Senatit Akademik, si dhe shkresën 2951/1 prot., datë 22.12.2022, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në Inxhinieri Mekanike, me nënfushë Inxhinieri Mekanike dhe nënfushë Inxhinieri e Materialeve, si dhe të miratojë katër projektet kërkimore-shkencore në: “Studim mbi vlerësimin numerik të emetimeve ndotëse nga motorët me djegie të brendshme. Rast studimi: Situata në Shqipëri, vlerësime dhe rekomandime për arritjen e targeteve të vitit 2030 në përputhje me Planin Kombëtar për Energjinë dhe Ndryshimet Klimatike 2021 -2030; “Studimi i vetive elektrike të fibrave tekstile dhe ndikimi i tyre në proceset e përpunimit”; “Modelimi dhe optimizimi i proceseve të prodhimit dhe zinxhirit të furnizimit në Shqipëri”; “Optimizimi i proceseve industriale të përpunimit të disa lidhjeve për deformim të aluminit dhe studimi i prodhimit eksperimental,

formësimit dhe karakterizimit të kompoziteve nanogrimcore AL-Qeramikë e avancuar”, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, në Universitetin Politeknik të Tiranës.

2. Tarifa e shkollimit për këtë program studimi është 450 000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

Anëtar
Jorgaq KACANI

Anëtar
Mirela BIMO

Anëtar
Fatjon DHULLI

Anëtar
Arjan BEQIRAJ

Anëtar
Alfred PJETRI

Anëtar
Adrian NAÇO

Kryetar
Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2916/Prot.

5

Tiranë, më 29/12 /2022

V E N D I M (QARKULLUES)

Nr. 43 , datë 29.12 .2022

PËR

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË
CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË INXHINIERI NDËRTIMI, ME
NËNFUSHË INXHINIERI NDËRTIMI NË FAKULTETIN E INXHINIERISË SË
NDËRTIMIT NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 41, datë 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM – në nr. 185, datë 25.03.2021, udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e “Studimeve të Doktoratës në Universitetin Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregulloreve të funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”, Vendimin nr. 26, datë 22.12.2022 të Senatit Akademik, si dhe shkresën 2916/3 prot., datë 22.12.2022, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në Inxhinieri Ndërtimi, me nënfushë Inxhinieri Ndërtimi, si dhe të miratojë tre projektet kërkimore-shkencore në: “Analiza e strukturave të përbëra (çelik-beton)”; “Sjellja e kolonave prej betoni të armuar me shufra GFRP dhe me agregat nga betoni i ricikluar”; “Vlerësimi i fenomeneve negative të dherave nga provat e terrenit (CPT, SPT) dhe krahasimi me rezultatet e investigimeve klasike – Porti i Durrësit dhe i Vlorës”, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Universitetin Politeknik të Tiranës.

2. Tarifa e shkollimit për këtë program studimi është 450 000 (katërqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI





REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 3051/1 Prot.

Tiranë, më 30/12 /2022

V E N D I M (QARKULLUES)

Nr. 44 , datë 30 . 12 .2022

PËR

MBËSHTETJEN FINANCIARE TË PERSONELIT TË UPT

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin nr. 898, datë 29.12.2022 të Këshillit të Ministrave “Për mbështetjen financiare të menjëhershme të punonjësve të njëjsve të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës”; Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës; vendimin nr. 13, datë 17.11.2016 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit të Universitetit Politeknik të Tiranës”; si dhe relacionin Administratorit të Institucionit nr. 3051prot., datë 30.12.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë mbështetjen financiare për punonjësit e Universitetit Politeknik të Tiranës në masën:
 - 20 000 (njëzetmijë) lekë për personelin me pagë bruto nën 60 000 (gjashtëdhjetemijë) lekë;
 - 10 000 (dhjetemijë) lekë për personelin me pagë bruto mbi 60 000 (gjashtëdhjetemijë) lekë;
2. Efektet financiare të përballohen nga fondet në dispozicion të buxhetit 2022.
3. Ngarkohet Administratori i Institucionit për kryerjen e veprimeve financiare deri në datën 10 janar 2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT

KRYETAR

Adriana RISTANI

